

MBËSHTETJE REFORMËS NË SHËNDETËSI



TAKIMKET

Përrurohen sportelet e reja në spitalin e Lezhës

20



INFORMACIONI

Karta e të drejtave, nxënësit e "Qemal Stafës", etje për njohuri

19

LEZHË

Laura, zëri adoleshent në problemet e shëndetësisë

21



Të drejtat e pacientit, USAID dhe "Shëndet+" me nxënësit e gjimnazeve

Në takimet me nxënës të gjimnazit "Sami Frashëri" dhe "Qemal Stafa" në kryeqytet u diskutua dhe iu bënë të njohura të drejtat që ata kanë kur kërkojnë shërbim shëndetësor në poliklinika apo edhe spitale

18



Në takimet me nxënës të gjimnazit "Sami Frashëri" dhe "Qemal Stafa" në kryeqytet u diskutua dhe iu bënë të njohura të drejtat që ata kanë kur kërkojnë shërbim shëndetësor në poliklinika apo edhe spitale

Të drejtat e pacientit, USAID dhe "Shëndet+" me nxënësit e gjimnazeve

Artinda Gjypt

Gjimnazi "Sami Frashëri" në Tiranë është nga të paktat gjimnaze që ka edhe Grupin e Shëndetit, një grup i përbërë nga nxënës të kësaj shkolle, të angazhuar në aktivitete për ndërgjegjësimin e bashkëmoshatarëve të tyre për çështje që lidhen me shëndetin. Herë pas here ata mbledhen me njëri-tjetrin dhe diskutojnë lidhur me problematika të ndryshme. Në aktivitetin më të fundit të organizuar nga projekti i USAID-it "Mbështetje Reformës në Shëndetësi", në bashkëpunim dhe me gazetën "Shëndet+", u diskutua lidhur me Kartën Shqiptare të Drejtave të Pacientit. Në këtë diskutim me nxënës të klasave të 10-12-ta u fol lidhur me të drejtat e pacientëve në vendin tonë dhe mënyrën se si të gjithë mund të kërkojnë një shërbim shëndetësor më të mirë në momentin që ata kanë nevojë.

Dudushi: Kërkoni të drejtat tuaja
Përfaqësuesja e projektit të USAID-it, Blerina Dudushi, në këtë aktivitet tha se shumica e të rinjve nuk kanë dijeni lidhur me të drejtat e pacientit. Ajo ndau fletëpalosje në të cilat tregoheshin ndodhjet e Kartës së Drejtave të Pacientit, fletëpalosje të cilat nxënësit mund t'ua çonin edhe prindërve. Ndër to,

Dudushi theksoi të drejtën që ka një pacient për të dhënë mendimin e tij para se të bëhet një veprim nga mjeku. Duke qenë se privatësia apo konfidencialiteti është një nga problemet e ngritura nga nxënësit, Dudushi theksoi se mjeku e ka detyrim që çdo bisedë me pacientin e tij ta mbajë të fshehtë. Pra, çdo pacient ka të drejtën e privatësisë.

"Të njihni dhe kërkoni të drejtat e pacientit në mënyrë indirekte ndikon edhe në uljen e korrupsionit, pasi në momentin që jeni të vetëdijshëm për to, mjekët do t'ju ofrojnë shërbim më cilësor", u shpreh Dudushi para nxënësve.

Bardhi: Denonconi dhe informohuni
Ndërkohë, drejtoresha e gazetës "Shëndet+", Eglantina Bardhi, u foli nxënësve lidhur me këtë gazetë, misionin e saj, si dhe faqen e internetit në të cilën ata mund të marrin të gjitha informacionet shëndetësore për të cilat kanë nevojë. Ajo deklaroi se nëse dëshironin të denoncin raste korrupsioni apo të kërkonin të dinin lidhur me sëmundje të ndryshme, mund të përdornin portalin shendeti.com.al. "Fakti që gazeta ka një bashkëpunim të ngushtë me mjekët, e bën informacionin e prezantuar në të shumë të saktë dhe dobiprurës për këdo", tha Bardhi.

Mjekja e shkollës, Teuta, e pranishme në këtë takim, ritheksoi edhe një herë për nxënësit e saj rëndësinë e informacionit për të pasur një shëndet më të mirë. "Siç ju kam shpjeguar edhe më parë, - tha ajo, - secili prej jush ka të drejtën për të pasur një shërbim shëndetësor të plotë. Ju keni të drejtën gjithashtu edhe të drejtën e konfidencialitetit, çka do të thotë që çdo gjë që ju ia thoni mjekut, ai ka detyrimin që të mos e përcjellë diku tjetër".

Nxënësit: Nuk ruhet privatësia nga mjekët
Ada Tafaj, pjesë e Grupit të Shëndetit në shkollën "Sami Frashëri", e pyetur se cila ishte çështja shëndetësore për të cilën interesoheshin më shumë gjimnazistët dhe cili ishte problemi më i madh që hasnin, tha se një ndër problemet më të mëdha që kishin nxënësit ishte privatësia. "Është e vështirë për ta që të shkojnë te mjeku i familjes dhe ta pyesin për gjëra që duan të dinë, si për shembull, për seksin, dhe të mos e marrë vesh gjithë fisi që ata kanë pyetur për këtë. Sepse mjeku i familjes njih mamin, babin, këdo dhe ajo për çka pyesin nuk mbetet private. Sigurisht seksi është një kuriozitet shumë i madh i të rinjve, për të cilin ata duan të dinë më shumë, por që nuk dinë

ku të drejtohen", u shpreh ajo.

Çështja e privatësisë u mbështet edhe nga nxënës të tjerë, që e cilësuan atë me shumë rëndësi. Tea Meço dhe Holger Qinami, përkatësisht në vitin e dytë dhe të tretë, të dy pjesë e Grupit të Shëndetit, u shprehën se ata janë aktivë përgjatë gjithë vitit dhe se marrin informacione të ndryshme lidhur me shëndetin dhe mënyrat për ta mbrojtur atë. "Ne aktivizohemi sidomos në ditët ndërkombëtare, siç po zhvillohet së fundmi Fushata kundër Kancerit të Mitrës, - tha Tea. - Në këto ditë organizohen takime, ku flitet për këto sëmundje dhe mënyrën se si mund të veprojmë".

Ndërkohë Holgeri theksoi se anëtarët e grupit komunikojnë me njëri-tjetrin jo vetëm në shkollë, por edhe në rrjetet sociale, duke dhënë e marrë informacione të ndryshme të nevojshme për ta. Grupi i Shëndetit i gjimnazit "Sami Frashëri" ka dhjetëra nxënës aktivë. Rreth 80 prej tyre janë ata që gjatë gjithë kohës marrin pjesë në fushata të ndryshme për ndërgjegjësimin e bashkëmoshatarëve. Të pranishmit në aktivitet morën edhe nga një kopje të gazetës "Shëndet+", ndërsa kërkuan edhe kontakte për të ditur ku të drejtohen në rastet kur hasin probleme.





Karta Shqiptare e të drejtave të pacientit

- 1- E drejta për masat parandaluese
- 2- E drejta për akses
- 3- E drejta për informim
- 4- E drejta për pëlqim
- 5- E drejta për zgjedhje të lirë
- 6- E drejta për privatësi dhe konfidencialitet
- 7- E drejta për respektimin e kohës së pacientit
- 8- E drejta për të marrë shërbim shëndetësor cilësor të standardeve të larta.
- 9- E drejta për shërbim të sigurt dhe të mbrojtur nga rreziqet
- 10- E drejta për të përfituar nga novacionet dhe arritjet shkencore bashkë-kohore mjekësore.
- 11- E drejta për të evituar vuajtjen dhe dhimbjen e panevojshme
- 12- E drejta për trajtim në bazë të veçorive individuale
- 13- E drejta për ankimim
- 14- E drejta për kompensim
- 15- E drejta për t'u organizuar aktivisht në shoqata joqeveritare për të bërë avokatin/mbrojtësin e të drejtave të pacientit
- 16- E drejta për të marrë pjesë aktivisht në politikëbërjen në fushën e shëndetësisë dhe përmirësimin e cilësisë në sistemin shëndetësor.

Karta e të drejtave, nxënësit e "Qemal Stafës", etje për njohuri

Shumë prej nxënësve u shprehën skeptikë në pikën e cilësuar në Kartën e të Drejtave të Pacientit lidhur me të drejtën për kompensim në raste të gabimeve nga ana e mjekëve

Në gjimnazin "Qemal Stafë" në Tiranë ka nxënës të klasave të fundit të cilët kanë zgjedhur që e ardhmja e tyre të jetë e lidhur drejtpërdrejt me shëndetësinë dhe që shprejnë që së shpejti të jenë ata kuruesit e të tjerëve. Në takimin e zhvilluar nga "Shëndet+" në bashkëpunim me projektin e USAID-it "Mbështetje Reformës në Shëndetësinë" lidhur me të drejtat e pacientit në Shqipëri, pati debate të mëdha për problemet që lidhen me shëndetin. Edhe pse njohuria e tyre mbi kartën ishte e ulët, dëshira e tyre dhe informacioni i marrë për çështje të ndryshme ishte i madh.

Drejtoresha e "Shëndet+", Eglantina Bardhi, foli përpara nxënësve të klasave të 12-ta për të drejtat që ata kanë për të marrë një shërbim shëndetësor falas, si dhe me standarde të larta. "Të gjithë ju që jeni nën moshën 18 vjeç dhe vazhdoni shkollën keni të drejtë të merri shërbim shëndetësor falas, - u shpreh Bardhi, - pavarësisht nëse jeni të siguar apo jo. Kështu jeni ju ata që nuk duhet të nxisni dhënien e pagesës ndaj mjekëve apo të denonconi rastet kur mjekët apo dikush tjetër në sistem ju kërkojnë pagesë për të marrë shërbimin shëndetësor që ju nevojitet". Të gjithë nxënësit ishin të informuar lidhur me nevojën e të pasurit të një librezhe shëndetësore, pavarësisht se fatmirësisht nuk u ishte dashur ta përdornin dhe kishin njohuri për lidhjen e drejtpërdrejtë që duhet të kishin me mjekun e familjes, si dhe rolin e tij për të kaluar më pas në hallka të tjera. Por shumë prej nxënësve u shprehën skeptikë në pikën e cilësuar në Kartën e të Drejtave të Pacientit lidhur me të drejtën për kompensim në raste të gabimeve nga ana e mjekëve. "Asgjë nuk mund të ta zëvendësojë gabimin që mund të bëjnë ata apo jetën që mund ta marrin", thanë nxënësit, duke pasqyruar kështu edhe mendimin e përgjithshëm të familjeve shqiptare për vetëdorëzimin që bëjnë përballë

sistemit shëndetësor në vend edhe në raste kur nuk janë trajtuar siç duhet.

Nga ana tjetër, një debat i mirëfilltë u hap edhe lidhur me njohuritë që vetë nxënësit kishin për sëmundje të ndryshme dhe paragjykimet që ata mund të kishin për çështje të tilla si për shembull, të personat me HIV/AIDS. Informacioni i shumicës ishte i saktë lidhur me mënyrat e transmetimit, rrezikshmërinë e infektimit, por edhe komunikimin me persona të tjerë që mund të ishin të infektuar. Kishte prej tyre tepër të hapur për t'u shoqëruar me individë që mund të ishin të infektuar dhe të tjerë që kishin ende drojë për sa e drejtë mund të ishte një veprim i tillë nga ana e tyre. Gjithsesi, në një këndvështrim të përgjithshëm dukej një ndryshim i madh për nivelin e informacionit të marrë krahasuar me vitet e shkuara. Karta e të Drejtave të Pacientit është në qendër të vëmendjes të sensibilizimit që po bëhet aktualisht në gjimnazet në vend nga ana e projektit të USAID-it "Mbështetje Reformës në Shëndetësinë", si dhe gazetës "Shëndet+". Kjo për faktin se përmes nxënësve mund të edukohet si brezi i ri, por ashtu edhe i vjetër. Të gjithë nxënësve të pranishëm në takim iu kërkua që fletët në të cilat ndodheshin të shkruara të drejtat e pacientëve të dërgoheshin edhe në shtëpi, pasi në këtë lloj mënyre mund të informonin edhe prindërit e tyre.

Një interes të madh nga ana e nxënësve pati edhe për të mësuar lidhur me faqen e internetit të gazetës "Shëndet+", e cila u dedikon edhe adoleshentëve një sektor të veçantë në të cilën mund të kërkojnë për probleme të ndryshme.

"Jeni të ftuar të na shkruani për gjithçka që dëshironi të dini. Përgjigja do t'ju jepet nga mjekë të specializuar," u tha Bardhi nxënësve. Gjithashtu ata u ftuan që të denoncojnë raste abuzimi me të cilat mund të ndeshen.



"Shëndet+" dhe shendeti.com.al, në mbështetje të reformës në shëndetësi

Shoqata "Together For Life" ka nisur misionin e saj për informim, ndërgjegjësim dhe advokim në mbështetje të pacienteve, në sistemin shëndetësor. Nëpërmjet gazetës "Shëndet Plus" dhe faqes së internetit shendeti.com.al po mundësohet informimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës për çdo aspekt që ka lidhje me shëndetin dhe sistemin shëndetësor. Ky projekt është mundësuar nga projekti i USAID-it "Mbështetje Reformës në Shëndetësi". Aktualisht janë shpërndarë postera ndërgjegjësuës në spitalin e Lezhës, spitalin e

Korçës, maternitetin "Mbretëresha Geraldinë" dhe në shkollat e mesme të këtyre qyteteve. Përkishtë gjatë ceremonisë për përzurimin e sallave të shërbimit ndaj publikut në Spitalin Rajonal Lezhë, në praninë e Kryeministrit Rama dhe të Ambasadorit Amerikan Arvizu u vunë re edhe posterat që ka shpërndarë shoqata "Together For Life". Ky poster përmban informacion për portalin shendeti.com.al në të cilin ndodhet edhe një dritare e hapur ku çdo pacient mund të denoncojë dhe raportojë abuzimet që mund të ndeshin në sistemin shëndetësor.



Projekti Mbështetje Reformës në Shëndetësi vijon progresin e tij në spitalin e Lezhës duke siguruar një shërbim më cilësor për të gjithë pacientët e këtij rrethi

Përrurohen sportelet e reja në spitalin e Lezhës

Kryeministri Edi Rama së bashku me ministrin e Shëndetësisë, Ilir Beqaj, dhe Ambasadorin amerikan në Tiranë, Aleksandër Arvizu, ishin në Lezhë për të përzuruar rinovimet e financuara nga USAID në Spitalin Rajonal. USAID ka rikonstruktuar 3 salla pritjeje për pacientët (receptions): në godinën kryesore, në repartin e urgjencës dhe në godinën e maternitetit, ka krijuar farmacinë qendrore të spitalit, dhe ka ndërtuar rampa (pjerrina) të ndryshme për karrocet ose barrelat për zhvendosjen e pacientëve. Kjo nisim e financuar nga qeveria amerikane është pjesë e projektit "Mbështetje Reformës në Shëndetësi".

Kryeministri Rama vlerësoi se ky projekt është një tjetër shembull i qasjes që qeveria ka për ndërtimin e marrëdhënieve cilësisht të reja të shtetit me qytetarët.

"Ky projekt i realizuar është ndër shembujt më të parë të një transformimi në vijim të të gjitha pi-

kave të kontaktit me shtetin, në spital, në çdo zyrë të shtetit. Meqë jemi tek spitalet, qoftë njerëzit në nevojë për kurë, qoftë familjarët e tyre, meritojnë të mikpritjen në kushtet më optimale, ashtu siç mikpritjen qytetarët e një vendi normal evropian", u shpreh Kryeministri Rama.

Teksa shprehu kënaqësinë që ky përzurim përkon edhe me nisjen e taksimit të ri lehtësues ndaj pagave të personelit mjekësor, Kryeministri garantoi për vijimësinë e mbështetjes ndaj tyre.

"Është kënaqësi, - nënvizoi ai, - që kjo ditë përkon me ditët kur gjithë personeli i spitaleve po merr rrogat me taksimin e ndershëm. Jam i bindur se kjo do të ndikojë shumë edhe në forcimin e marrëdhënieve mes personelit spitalor, Ministrisë së Shëndetësisë, qeverisë si e tërë, pushtetit vendor, komunitetit, por po ashtu do të ndikojë më tutje që ne të vazhdojmë të rrisim mundësitë e gjithë atyre që shërbejnë në spitale, për të pasur më shumë pa-

ra nga puna e tyre e ndershme dhe sigurisht për të jetuar më mirë."

Nga ana e tij, Ambasadori Arvizu shprehu mbështetjen ndaj qasjes së qeverisë shqiptare për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe përmirësimin të praktikave për shërbime gjithnjë e më cilësore.

"Jemi të kënaqur që jemi pjesë e këtij projekti dhe gjithashtu, shumë krenarë që USAID-i ka qenë pjesë e kësaj mundësie. Mendoj që kjo është një mundësi e shkëlqyer e të punuarit së bashku me qeverinë, në mënyrë që të mund t'i ofrohen qytetarëve shërbimeve më cilësore, veçanërisht është shumë e rëndësishme për sa i përket ofrimin të shërbimeve në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe të gjitha këto ndihmojnë në një qeverisje më të mirë. Diçka për të cilën jemi shumë krenarë, këtu në Lezhë, është fakti i krijimit të një paneli konsultativ me komunitetin që do të punojë së bashku

me komunitetin. Shtetet e Bashkuara vërtet janë shumë krenarë që qeveria ka zgjedhur këtë qasje, për sa i përket bashkëpunimit me komunitetin, siç është bërë për shembull në fushën e arsimit dhe e njëjta gjë që po zbatohet në fushën e shëndetësisë", u shpreh ambasadori Arvizu.

Spitali Rajonal i Lezhës është një nga tre spitalet "pilot", të përfshira në projektin e USAID-it, për të mbështetur ngritjen e një sistemi më të mirë menaxhimi dhe shërbimi. Këtë model, ministri Beqaj premti se do ta shtrijë në të gjitha spitalet e vendit. "Jemi angazhuar që spitalet t'i kemi jo vetëm qendra kurimi, por si qendra ku ngjizet solidariteti njerëzor. Ky projekt ka pacientin, në qendër të kujdesit shëndetësor. Është detyra ime dhe e bashkëpunëtorëve të mi që ndihmën e vyer dhe eksperiencën e fituar në këtë spital ta shtrijmë në gjithë spitalet e Shqipërisë", u shpreh ministri Beqaj.



Më e vogla e Panelit Këshillimor Qytetar të Lezhës tregon lidhur me përkushtimin që ajo ka në përmirësimin e shërbimit që marrin bashkëmohatarët por edhe qytetarët e ndryshëm nga sistemi shëndetësor

Laura, zëri adoleshent në problemet e shëndetësisë

Laura është një adoleshente si gjithë bashkëmohatarët e saj, por kjo nuk e pengon aspak atë të ulet në një tavolinë bashkë me të rriturit dhe të japë mendimin dhe kontributin e saj për këtë shoqëri. Madje, ajo guxon dhe me zërin e saj flet hapur edhe për vendime të rëndësishme që duhet të merren në struktura të larta, siç është ajo e shëndetësisë. Laura Gjopalaj është pjesë e Panelit Këshillimor Qytetar Lezhë për spitalin e Lezhës. Edhe pse më e vogla e këtij paneli, ajo nuk heziton të japë kontributin e vet. “Ky panel është ngritur për herë të parë në qytetin tonë dhe kjo më bën vërtet të ndihem mirë. Falë projektit “Mbështetje Reformës në Shëndetësi” mbështetur nga USAID po realizojmë nisma të reja dhe në dobi të spitalit dhe të qytetit tonë. Mendoj se këto nisma janë shumë të domosdoshme dhe nuk duhet të lihen pas dore, por të vazhdojnë përpara në realizimin e përpiktë të tyre”, pohon Laura, e cila është edhe drejtuese e komitetit rinor të Lezhës.

Ndërkohë, ajo shpjegon se si është bërë pjesë e këtij paneli, edhe pse nuk e kishte dëgjuar kurrë më parë. “Një ditë më telefonuan nga personeli i spitalit dhe më shpjeguan diçka në telefon. Më ftuan të merrja pjesë në aktivitetet e tyre. Në fakt në fillim nuk e kuptova sa duhet, sepse as nuk e kisha menduar se mund të isha edhe unë pjesë e një tavoline, aq më tepër në sektorin e shëndetësisë dhe pikërisht aty ku ulen doktorë, ekspertë apo profesorë. Në fakt, impakti i parë kështu mendohet, por ky panel ka në përbërje të tij edhe njerëz të thjeshtë që vijnë pikërisht nga komuniteti, që

do të thotë se populli vetë ulet në një tryezë për të folur rreth çështjeve që e shqetësojnë”, thotë Laura. Sipas saj ky panel tashmë është bërë pjesë e punës së saj dhe është gjithnjë korrekte në takimet që janë realizuar.

Më tej shpjegon se prania e saj në këtë panel do të thotë përfaqësim i problemeve që kanë të rinjtë e qytetit të saj me sistemin shëndetësor. “Unë flas hapur në këtë panel dhe shtroj të gjitha problemet që mund të kenë bashkëmohatarët e mi përpara i takon aksesit në shërbimin shëndetësor. Sigurisht që moshatarët e mi nuk kanë probleme sa mund të kenë grupmoshat e tjera dhe komunitetet e tjera, megjithatë edhe ne kemi nevojë për më shumë shërbime dhe kujdes. Kështu mendoj se informimi dhe edukimi shëndetësor nuk është në nivele të mira për bashkëmohatarët e mi, ndaj duhet punuar më shumë në këtë drejtim duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat për ta realizuar këtë”.

ZGJEDHJA DHE KOHA E QËNDRIMIT NË POZICIONIN E NËN-DREJTORIT

Nën-drejtori i panelit përzgjidhet me votim nga anëtarët e panelit për një periudhë 1 vjeçare. Koha mund të zgjatet deri në tre vjet (me përzgjedhje vjetore).

SEKRETARIATI

Sekretarja/i i panelit përzgjidhet me votim nga anëtarët e panelit për një periudhë 1 vjeçare. Koha mund të zgjatet deri në tre vjet (me përzgjedhje vjetore).

Por kontributi i Laurës nuk ka të bëjë vetëm me moshatarët që ajo përfaqëson, por e ulur rreth një tryeze me përfaqësues të spitalit, të bashkisë, të politikës etj, ajo mundet të dëgjojë e të mësojë edhe në lidhje me problemet që realisht mundojnë komunitetin sa i takon sektorit të shëndetësisë.

“Qëllimi i këtij projekti është që shoqëria civile të ketë zërin e saj në vendimmarrje sa i takon shërbimit shëndetësor. Kjo është pozitive dhe kam shpresë se në këtë mënyrë do të fillojnë të funksionojnë edhe më mirë gjërat”, përmbyll Laura Gjopalaj.

Komunikimi me bashkëmohatarët

Adoleshentja Laura Gjopalaj nuk diskuton dhe jep mendime vetëm në tavolina pune, por ajo di të jetë efektive edhe në terren. Madje për problemet që diskutohen në tavolinën e Panelit Këshillimor Qytetar Lezhë për spitalin e Lezhës, ajo i bisedon edhe me moshatarët e saj duke i informuar ata në lidhje me risitë që po realizohen në spitalin e qytetit të tyre. “Unë kam vite që punoj vullnetare për komunitetin në lidhje me çdo problem social që i shqetëson ata. Kështu flas shpesh edhe me grupet e moshatarëve të mi në lidhje me risitë dhe çdo gjë që po realizohet në spital. Kuptohet jo të gjithë mund të kuptojnë ndryshimin, por e rëndësishme është që ne të japim kontributin tonë gjithmonë në mënyrë që gradualisht të vihen re këto ndryshime”.

Funksionet e Panelit Këshillimor Qytetar Lezhë

Paneli Këshillimor Qytetar Lezhë institucionalizohet si organ këshillimor i Spitalit Rajonal Lezhë me anë të një Vendimi të nxjerrë nga SRL. Paneli Këshillimor Qytetar Lezhë kërkon pjesëmarrje vullnetare dhe të barabartë të anëtarëve në takimet e saj. Çdo anëtar i shoqatave lokale apo komunitetit të biznesit do të zgjedhë një person kontakti që do të bashkërendojë punët me Spitalin Rajonal Lezhë dhe Projektin MRSH.

1. Përfaqësojë Zërin e komunitetit – në emër të komunitetit, nxit stafin e Spitalit Rajonal Lezhë që të përpiqet për të bërë më të mirën në shërbimin shëndetësor që ofrojnë. Ngre çështje, i diskuton ato, ofron një platformë për ndërveprim të drejtpërdrejtë midis përfaqësuesve të SRL dhe komunitetit.
2. Shërben si një urë lidhëse midis SRL dhe komunitetit.
3. Organizon takime për të angazhuar anëtarët e panelit në dialog mbi Spitalin Rajonal Lezhë.
4. Vepron si një burim edukimi për Spitalin Rajonal Lezhë dhe e vë në dijeni për problematikat e komunitetit dhe nevojat në lidhje me shërbimet e ofruara në Spital.
5. Rishikon me drejtuesit ndryshimet e propozuara për programet dhe shërbimet e pacientëve si dhe jep sugjerime mbi to.
6. Merr pjesë në procesin e planifikimeve strategjike dhe zhvillimet për planet e veprimit klinike.
7. Rishikon e jep mendime në planin e buxhetimit operacional dhe procesin e alokimit të burimeve.
8. Mbështet SRL në përpjekjet e tij për tu shndëruar në një qëndër ekselence për komunitetin.
9. Ofron udhëzime dhe drejton në lidhje me ndërthurjen e mendimit të komunitetit dhe përdoruesve të shërbimit shëndetësor të ofruar nga SRL në rajonin Lezhë në të gjitha nivelet operacionale.
10. Mbron interesat – jep mendime për Drejtuesin e Spitalit Rajonal Lezhë sa herë që t'u kërkohet apo të jetë e nevojshme
11. Konsulton dhe këshillon – përqendrohet në standartet e ofrimit dhe cilësinë e shërbimeve si dhe tematika të tjera që lidhen me zhvillimet pozitive të SRL
12. NUK janë vendimmarrës – qëllimi është të ofrojnë kontributin e shoqërisë civile; autoriteti për marrjen e vendimeve dhe hartimin e politikave janë të Spitalit Rajonal Lezhë.



KOHËZGJATJA

Çdo anëtar i panelit duhet të shërbejë për një periudhë 3-vjeçare (periudha 1) dhe mund të nominohet maksimumi 2 herë rresht si anëtar (2 periudha të njëpasnjëshme ose 6 vjet). Anëtarët e panelit duhet të shërbejnë me mbivendosje në panel që do të thotë se në panel duhet të ketë 3 anëtarë të “vjetër” e 3 anëtarë të “rinj”. Ata vendosen çdo vit gjatë takimit të përgjithshëm vjetor.

ZGJEDHJA DHE KOHA E QËNDRIMIT NË POZICIONIN E DREJTUESIT

Drejtuesi i Panelit përzgjidhet me votim nga vetë anëtarët e panelit për një periudhë 1 vjeçare. Kohëzgjatja mund të jetë maksimumi 3 vjet (me përzgjedhje vjetore).